

# ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR NUMRI 107 | gusht-shtator 2017

**Edukimi financiar dhe kujdesi për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, do të jenë në qendër të punës së AMF-së**

## Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2017

## Zhvillime të tjera

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takim me përfaqësues të FMN-së
- Përfaqësues të lartë të SECO-s takim me Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv
- AMF nis trajnimet në fazën e tretë të projektit për zhvillimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregullimin në tregun e kapitaleve
- Drejtuesit e AMF-së, takime të nivelit të lartë bilateral në Maqedoni
- Zhvillohet konferenca “Mbrojtja e konsumatorit në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve - Trendet e mbrojtjes së konsumatorit në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve”
- Zhvillohet konferenca e pestë vjetore e mbikëqyrjes globale të sigurimeve
- Zhvillohet programi i trajnimit “Train the Trainers” për aktuar

## Edukimi i Konsumatorit

- Rregullimi i tregjeve financiare dhe mbikëqyrja e sigurimeve gjithëpërfshirëse

## Lajme Ndërkombëtare

- Maqedoni
- Itali
- Greqi
- Rumani
- Sllovaki

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Edukimi financiar dhe kujdesi për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, do të jenë në qendër të punës së AMF-së

Z. Koçi u ndal te problemi i mbartur ndër vite me Fondin e Kompensimit, duke theksuar se AMF po punon për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare brenda vitit 2018.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi gjatë konferencës me mediat*

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, zhvilloi më datë 26 shtator një konferencë me mediat në lidhje me zhvillimet më të fundit në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Në fillim të fjalës së tij, Z. Koçi u ndal te ndryshimet strukturore në AMF, të tilla që reflektojnë zhvillimet aktuale të tregjeve dhe marrjen e përgjegjësive reale për të garantuar të drejtat dhe interesat e konsumatorëve. Z. Koçi e vlerësoi si mjaft të rëndësishëm komunikimin me median, duke i ftuar gazetarët në komunikime të përbashkëta periodike.

Më tej, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv bëri një pasqyrim të zhvillimeve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Sipas të dhënave më të fundit, tregu i sigurimeve, për periudhën janar-gusht ka shënuar një rritje me rreth 12% të volumit të primeve, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shoqëruar gjithashtu me një rritje me 31% të dëmeve të paguara nga kompanitë. Z. Koçi u ndal te problemi i mbartur ndër vite me Fondin e Kompensimit, duke theksuar se AMF po punon për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare brenda vitit 2018.

“Gjatë këtyre muajve kemi qenë të fokusuar edhe për kryerjen e pagesave të Fondit të Kompensimit, një gangrenë tjetër që ka pasur tregu, nga shoqëritë që operojnë në tregun e sigurimeve, ku detyrimet e Fondit të Kompensimit datojnë qysh prej vitit 2002, pra përpara 15 vjetësh, të pashlyera. Ne jemi të angazhuar që brenda vitit 2018 të mos kemi asnjë pagesë të prapambetur për dëmet që i takojnë periudhave 2002-2016. Pagesat tashmë kanë filluar nga ngjarjet më të hershme dhe shoqëritë kanë marrë përgjegjësitë që u takojnë” – theksoi Z. Koçi.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi gjithashtu se Autoriteti, me asistencën e organizmave ndërkombëtare, po punon ende për të përmirësuar Ligjin "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" në pjesë të veçanta të tij, përpara se të miratohet në Parlament. Kjo, edhe pas problematikave që kanë dalë së fundi në treg mbi luhatjet e çmimeve apo mbi nivelin e përgjegjësive mbi palët e treta, duke e orientuar të gjithë projektligjin në rritjen e besimit të publikut.

—○○○—  
Drejtori i Përgjithshëm  
Ekzekutiv i AMF-së apeloi  
edhe njëherë për të bërë  
shumë kujdes në rastet e  
investimeve në platformat  
online.

Z. Koçi pasqyroi edhe zhvillimet më të fundit në tregun e investimeve, ku evidentoi edhe licencimin e të parës Bursë shqiptare të titujve. Kjo, - u shpreh Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, - do të ndihmojë në zhvillimin më të mirë të tregut sekondar të letrave me vlerë, zgjerimin e mundësive për financim nga ana e sipërmarrësve, në përdorimin më efektiv të parasë dhe në krijimin e një energjie pozitive për ekonominë e vendit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së apeloi edhe njëherë për të bërë shumë kujdes në rastet e investimeve në platformat online, ndërsa vlerësoi rolin e medias në këtë drejtim për të bërë që konsumatorët e këtij produkti të investojnë vetëm në platforma të sigurta dhe të licencuara. Z. Koçi prezantoi edhe treguesit e fundit statistikorë të zhvillimit të tregut të fondeve private vullnetare të pensionit, i cili vazhdon të mbetet një treg shumë i vogël dhe i brishtë. Ai kërkoi edhe mbështetjen e mediave për të rritur më tej ndërgjegjësimin e publikut për pjesëmarrje në këto skema private pensionesh.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-gusht 2017 kapën vlerën mbi 10.50 miliardë lekë, ose 11.98% më shumë se gjatë periudhës janar-gusht 2016. Gjatë periudhës janar-gusht 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 821,134 me një rritje prej 15.44% krahasuar me periudhën janar-gusht 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 30.88% në krahasim me periudhën janar-gusht 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 2.06 miliardë lekë, apo 59.98% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 10.94% gjatë periudhës janar-gusht 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-gusht 2016.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 6.53 miliardë lekë gjatë periudhës janar-gusht 2017, duke shënuar një rritje prej 13.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.35% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

■ Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 11.73% të tregut të Jo-Jetës;

■ Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 11.51 % të tregut të Jo-Jetës.


### Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rriten me 27.23% krahasuar me periudhën janar-gusht 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 64.43% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 6.53 miliardë lekë gjatë periudhës janar-gusht 2017.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



## ZHVILLIME TË TJERA

### Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkroi më datë 11 shtator 2017, Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve "Inspektimet e përbashkëta në shoqëritë e sigurimeve dhe subjektet e tjera në mbikëqyrje të AMF-së dhe shkëmbimin e informacionit".

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkroi më datë 11 shtator 2017, Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve "Inspektimet e përbashkëta në shoqëritë e sigurimeve dhe subjektet e tjera në mbikëqyrje të AMF-së dhe shkëmbimin e informacionit".



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Drejtorja e Përgjithshme e DPT-së Zj. Vasilika Vjero gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shërben si bazë bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, me qëllim kryerjen e inspektimeve të përbashkëta midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas afateve dhe rregullave procedurale në fuqi për kontrollin, si dhe shkëmbimin e informacioneve në funksion të këtyre inspektimeve.

Objekt i inspektimeve të përbashkëta do të jenë zbatimi i dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e tregjeve financiare në mbikëqyrje, ligjshmëria e kryerjes së shpenzimeve nga ana e shoqërive të sigurimeve, policat e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, si edhe ligjshmëria e veprimtarisë së subjekteve nën mbikëqyrjen e AMF-së.

### **Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takim me përfaqësues të FMN-së**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi priti në një takim përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, me të cilët diskutoi në lidhje me ecurinë e tregjeve financiare, me fokus të veçantë tregjet e kapitaleve dhe rolin e Autoritetit në mbikëqyrjen, rregullimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu. Z. Koçi informoi përfaqësuesit e FMN-së për ndryshimet e fundit në strukturën e AMF-së, e cila u përmirësua për t'iu përgjigjur më efektivisht zhvillimeve dinamike të tregjeve nën mbikëqyrje. Struktura e re ka parashikuar edhe një njësi të dedikuar për mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi dhe drejtues të lartë të AMF-së gjatë takimit me FMN-në*

---

Z. Koçi i bëri të ditur përfaqësuesve të Fondit Monetar Ndërkombëtar se AMF i ka kushtuar vëmendje të veçantë edukimit financiar të publikut dhe mbrojtjes së investitorëve që operojnë në tregun e kapitaleve.

---

Z. Koçi i bëri të ditur përfaqësuesve të Fondit Monetar Ndërkombëtar se AMF i ka kushtuar vëmendje të veçantë edukimit financiar të publikut dhe mbrojtjes së investitorëve që operojnë në tregun e kapitaleve. Në këtë kuadër, Autoriteti ka miratuar së fundmi edhe strategjinë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit”.

Në takim u diskutua për licencimin e Bursës së parë private të titujve, mbikëqyrjen dhe strategjinë e komunikimit për menaxhimin e krizave përsa i

përket fondeve të investimit dhe punën e bërë nga AMF për të garantuar stabilitet, transparencë dhe mbrojtje për konsumatorët. Nga ana e saj, FMN shprehu gadishmërinë për të vazhduar asistencën në drejtim të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së.

## **Përfaqësues të lartë të SECO-s takim me Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi zhvilloi më 13 shtator 2017 një takim me përfaqësues të lartë të Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO). Në takimin e zhvilluar me Ambasadorin Raymund Furrer, Drejtor i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit, i cili shoqërohej nga Ambasadori i Konfederatës Zviceriane në Tiranë, Z. Christoph Graf dhe përfaqësues të tjerë të SECO-s në Shqipëri, u diskutua për mbështetjen e vazhdueshme që Qeveria Zvicerane i ka dhënë Shqipërisë, e në veçanti Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet financimit të projekteve strategjike.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi dhe drejtues të lartë të AMF-së gjatë takimit me përfaqësuesit e SECO-s*

Projekti i financuar nga SECO, merr rëndësi të veçantë në kuadër të zhvillimeve të shpejta dhe dinamikës së lartë të zgjerimit që ka përjetuar industria e fondeve të investimit, duke u klasifikuar si tregu i dytë më i rëndësishëm pas tregut bankar.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së falenderoi përfaqësuesit e lartë të SECO-s për ndihmën e dhënë me projektin aktual për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve. Z. Koçi vuri në dukje rëndësinë që ka ky projekt jo vetëm për Autoritetin, por edhe për investitorët dhe ekonominë e vendit.

“Projekti i financuar nga SECO, merr rëndësi të veçantë në kuadër të zhvillimeve të shpejta dhe dinamikës së lartë të zgjerimit që ka përjetuar Industria e fondeve të investimit, duke u klasifikuar si tregu i dytë më i rëndësishëm pas tregut bankar. Vlera neto e aseteve të fondeve të investimit është rreth 5% e GDP-së, më e larta ndër vendet e Evropës Juglindore. Me mbështetjen e madhe që ka dhënë dhe po jep për Autoritetin, SECO është një bashkëpunëtor i rëndësishëm në misionin tonë për mbikëqyrjen e tregjeve, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit,” u shpreh Z. Koçi.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i shprehu përfaqësuesve të lartë të SECO-s gadishmërinë e Autoritetit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit, edhe pas përfundimit të tij. Ndërsa Ambasadori Furrer shprehu gjithë mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike në projektin e nisur për forcimin e kapaciteteve të AMF-së dhe vlerësoi rolin e Autoritetit në monitorimin dhe rregullimin e tregjeve nën mbikëqyrje.

Z. Furrer u informua në lidhje me sfidat me të cilat përballet AMF në mbikëqyrjen e tregjeve, ndryshimet e fundit strukturore në Autoritet që kanë si qëllim kryesor rritjen e efencës dhe mbrojtjen e konsumatorit, si edhe punën e nisur nga Autoriteti, me ngritjen e një Komiteti Këshillimor, për hartimin e strategjisë 5-vjeçare për zhvillimin e tregjeve dhe mbikëqyrjen e tyre.

### **AMF nis trajnimet në fazën e tretë të projektit për zhvillimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregullimin në tregun e kapitaleve**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në datat 19-20 shtator organizoi një *workshop* në nisje të trajnimeve të fazës së tretë të projektit "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve". Kjo fazë e tretë e projektit ka si objektivi kryesor kualifikimin profesional të specialistëve dhe ekspertëve në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të kapitaleve.



*Gjatë zhvillimit të projektit për zhvillimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregullimit në tregun e kapitaleve*

Nëndrejtorja Ekzekutive e AMF-së, Znj. Mimoza Kaçi theksoi se kjo fazë ka rëndësi të veçantë, pasi i ofron punonjësve të Autoritetit mundësinë për të thelluar njohuritë e tyre në rregullimin dhe mbikëqyrjen e një tregu me zhvillime dinamike në Shqipëri, siç është ai i letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve.

Në fjalën e mbajtur në këtë *workshop*, Nëndrejtorja Ekzekutive e AMF-së, Znj. Mimoza Kaçi theksoi se kjo fazë ka rëndësi të veçantë, pasi i ofron punonjësve të Autoritetit mundësinë për të thelluar njohuritë e tyre në rregullimin dhe mbikëqyrjen e një tregu me zhvillime dinamike në Shqipëri, siç është ai i letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve. Gjithashtu Znj. Kaçi



vlërësoi ekspertizën e dhënë nga dy ekspertët Znj. Sally Buxton dhe Z. Mark St. Giles, si edhe bashkëpunimin e frytshëm mes Bankës Botërore, Sekretariatit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe ekipit pranë Ministrisë së Financave, për mbarëvajtjen e këtij projekti.

Nëndrejtorja Ekzekutive u shpreh se kjo fazë e kualifikimeve profesionale për stafin e AMF-së vjen në momentin e duhur, paralelisht me ndryshimet strukturore në Autoritet, që synojnë të adresojnë më mirë zhvillimet në tregun e fondeve të investimeve dhe letrave me vlerë. Ky projekt, i nisur në vitin 2016, mbështetet nga Banka Botërore dhe financohet nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

## **Drejtuesit e AMF-së, takime të nivelit të lartë bilateral në Maqedoni**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi dhe Nëndrejtorja Ekzekutive, Znj. Mimoza Kaçi zhvilluan në datat 28-29 shtator 2017, në Maqedoni një vizitë zyrtare të nivelit të lartë bilateral me drejtuesit e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA). Gjatë takimeve u diskutuan çështje me interes dypalësh, si:

- Bashkëpunimi në mbikëqyrje dhe në shkëmbimin e informacionit;
- Ecuria e tregut të sigurimeve në Republikën e Maqedonisë;
- Produkti MTPL në Republikën e Maqedonisë; si dhe
- Aktivitete në kuadër të projektit të binjakëzimit: Europa RE, “Harmonizimi i mëtejshëm me BE-në në fushën e sigurimeve dhe rritja e operacioneve në treg.”

Në mënyrë periodike, dy autoritetet rregullatore zhvillojnë takime të përbashkëta pune që kanë për qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit për një mbikëqyrje efektive dhe dinamike të tregut të sigurimeve në të dy vendet. Kjo edhe për shkak të pranisë së kompanive shqiptare që operojnë në tregun e sigurimeve në Maqedoni. Në këtë kuadër, në muajin korrik, drejtuesit e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë zhvilluan një vizitë pune në AMF, me qëllim koordinimin dhe bashkëveprimin mes dy institucioneve, edhe përmes hartimit të një plani të përbashkët pune. Të dy autoritetet kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit që prej viti 2010.

## **Zhvillohet konferenca “Mbrojtja e konsumatorit në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve – Trendet e mbrojtjes së konsumatorit në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve”**

Banka Qendrore e Sllovakisë (NBS) në bashkëpunim me IAIS-IOPS-OECD zhvilluan në datat 18 dhe 19 shtator 2017, në Bratisllavë, konferencën me temë “Mbrojtja e konsumatorit në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve – Trendet e mbrojtjes së konsumatorit në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve”.

—○○○—  
Dy autoritetet rregullatore zhvillojnë takime të përbashkëta pune që kanë për qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit për një mbikëqyrje efektive dhe dinamike të tregut të sigurimeve në të dy vendet.

—○○○—

Programi i konferencës ishte i ndarë në 3 sesione:

1. Në sesionin e parë u diskutua mbi, ngjashmëritë dhe dallimet që kanë tregu i sigurimeve me atë të pensioneve dhe çështjet mbi mbrojtjen e konsumatorit. Përfaqësues të autoriteteve rregullatore, pjesëmarrëse në takim, identifikuan çështjet aktuale mbi mbrojtjen e konsumatorit dhe diskutuan mbi ngjashmëritë dhe dallimet në mbrojtjen e konsumatorit që lindin në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve. Në veçanti, ata u përqendruan se si këto çështje të identifikuar të mbrojtjes së konsumatorit janë trajtuar nga industria dhe nga mbikëqyrësit. Ata gjithashtu ofruan analiza të hollësishme në natyrën afatgjatë të produkteve të kursimit dhe të daljes në pension, metodat më efektive për dhënie informacioni konsumatorëve, si dhe mjetet edukative që mund t'i ndihmojnë konsumatorët në marrjen e vendimeve të tyre.

2. Në sesionin e dytë u diskutua mbi trendet e tregut dhe përfshirjen e tyre në mbrojtjen e konsumatorit në sektorin e pensioneve dhe sigurimeve. Vëmendje e veçantë iu kushtua: Digjitalizimit dhe FinTech, modeleve të reja të biznesit dhe mbikëqyrja e tyre, ndikimit të normave të ulëta të interesit në përfitimet e pensioneve dhe sigurimeve, aftësisë paguese dhe alokimit të aseteve të pensionistëve, si dhe politikave informative arsimore. Gjithashtu u diskutua se si mund të menaxhohen pritshmëritë e konsumatorëve në lidhje me pensionet e tyre të ardhshme.

3. Në sesionin e tretë u diskutua mbi standardet mbikëqyrëse dhe praktikën në mbrojtjen e konsumatorëve, në sektorin e pensioneve dhe sigurimeve. U prezantuan standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së konsumatorit të hartuara nga IAIS, IOPS, OECD dhe Banka Botërore. Drejtuesit e panelit i kushtuan një rëndësi të veçantë çështjeve dhe qasjeve në standardet më të fundit dhe praktikave me të mira të zhvilluara në fushën e mbrojtjes së konsumatorit në sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve.

Programi i konferencës përfshiu sesione mbi direktivën IDD (Insurance Distribution Directive) dhe rreziqet që rrjedhin nga shpërndarja e produkteve të sigurimeve, sidomos duke pasur në vëmendje mbrojtjen e konsumatorit si dhe dixhitalizimin dhe zhvillimin e inovacionit në sektorin e sigurimeve.

## **Zhvillohet konferenca “Mbrojtja e konsumatorit në epokën e re - zhvillimi i shpejtë dixhital përkundrejt rregullimit të tregut të sigurimeve”**

Autoriteti i Mbikëqyrjes i Sigurimeve të Sllovenisë (AZN) zhvilloi në datën 4 shtator 2017 konferencën e tretë vjetore me temë: “Mbrojtja e konsumatorit në epokën e re - zhvillimi i shpejtë dixhital përkundrejt rregullimit të tregut të sigurimeve”.

Programi i konferencës përfshiu sesione mbi direktivën IDD (*Insurance Distribution Directive*) dhe rreziqet që rrjedhin nga shpërndarja e produkteve të sigurimeve, sidomos duke pasur në vëmendje mbrojtjen e konsumatorit si dhe dixhitalizimin dhe zhvillimin e inovacionit në sektorin e sigurimeve.

Përfaqësues nga autoritete rregullatore ndanë mendimin se praktikën e dobëta të shitjes mund të dëmtojnë besimin e konsumatorit në sistemin e sigurimeve si



Qëllimi i konferencës ishte nxjerrja në pah e ndryshimeve rregullatore të shkaktuara nga direktiva IDD dhe sfidat e paraqitura nga këto ndryshime rregullatore, si dhe transformimi dixhital për siguruesit dhe për ndërmjetësit në sigurime.



i tërë dhe i shikojnë ndryshimet e ardhshme rregullatore si një mjet jetik për të rritur mbrojtjen e konsumatorit dhe për të përmirësuar praktikat e biznesit. Përveç kësaj, risitë teknologjike në fushën e shitjeve të sigurimeve dhe proceseve të tjera të sigurimeve do të kenë gjithashtu një ndikim të thellë tek siguruesit, proceset e tyre dhe në modelet e tyre të biznesit.



*Gjatë zhvillimit të konferencës*

Gjatë konferencës u ofruan analiza të hollësishme për pjesëmarrësit nga industria e sigurimeve, rregullatorët e sigurimeve, përfaqësuesit e konsumatorëve, gazetarët etj., mbi strukturën dhe zhvillimin e tregjeve në Evropën Qendrore dhe Lindore për sigurimin e Jetës, u diskutua qasja në shërbimet shëndetësore dhe rëndësia e inovacionit dixhital për shmangien e burokracive në shkëmbimin e dokumentacionit, i cili pengon riorganizimin e proceseve administrative, u propozua përdorimi i bazës së të dhënave të centralizuar evropiane të EIOPA-s mbi të dhënat e raportimit të Solvency II si vlerë e shtuar tek autoritetet mbikëqyrëse; roli i rregullatorit në mundësimin e dixhitalizimit të industrisë së sigurimeve, etj.

Qëllimi i konferencës ishte nxjerrja në pah e ndryshimeve rregullatore të shkaktuara nga direktiva IDD dhe sfidat e paraqitura nga këto ndryshime rregullatore, si dhe transformimi dixhital për siguruesit dhe për ndërmjetësit në sigurime.

### **Zhvillohet konferenca e pestë vjetore e mbikëqyrjes globale të sigurimeve**

Qendra e Bashkëpunimit për Rregullimin në Sigurime (ICIR), Qendra Kërkimore SAFE (*Sustainable Architecture for Finance in Europe*), Autoriteti Evropian i Pensioneve Profesionale dhe Sigurimeve (EIOPA) dhe grupi i Bankës Botërore zhvilluan në datat 6 dhe 7 shtator 2017 në Frankfurt, Gjermani konferencën e pestë vjetore të mbikëqyrjes globale të sigurimeve.



Në konferencë u pasqyruan zhvillimet në sektorin evropian dhe ndërkombëtar të sigurimeve, të cilat shërbyen si një platformë për shkëmbimin e ideve mbi çështje strategjike të rregullimit dhe mbikëqyrjes.



Në konferencë u pasqyruan zhvillimet në sektorin evropian dhe ndërkombëtar të sigurimeve, të cilat shërbyen si një platformë për shkëmbimin e ideve mbi çështje strategjike të rregullimit dhe mbikëqyrjes.

Çështjet kryesore të cilat u diskutuan gjatë konferencës, ishin:

- Risku sistemik, stabiliteti financiar dhe lidhja e tyre me tregun e sigurimeve. Për këtë qëllim u shtrua çështja e nevojës për një mbikëqyrje makroprudenciale dhe pasojat e kësaj mbikëqyrje për siguruesit dhe mbikëqyrësit. Gjithashtu u diskutua mbi rolin e rregullatorëve dhe mbikëqyrësve në zbutjen e riskut sistemik;
- Sfidat dhe mundësitë në industrinë e shërbimeve financiare;
- Mbrojtja konsumatore, sfidat e mbrojtjes konsumatore në vende të ndryshme, si dhe rolin që po merr mbrojtja konsumatorenë sektorin e sigurimeve;
- Diskutimet mbi mbrojtjen konsumatore u fokusuan në: informimin e konsumatorit, transparencën ndaj tij, trajtimin e dëmeve, ofrimin e produkteve të përshtatshme dhe të dobishme për konsumatorin, etj.;
- E ardhmja e rregullimit dhe mbikëqyrjes në nivel ndërkombëtar, aspekt ky që u diskutua edhe nga pikëpamja legjislative;
- Sigurimi i qendrueshëm - u diskutua në veçanti edhe mbi ndërlidhjen midis ndryshimeve klimaterike dhe financave të qëndrueshme, si dhe kontributin që mund të japë sektori financiar në këtë drejtim.

Të ftuar në konferencë ishin përfaqësues të autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse nga vende të ndryshme të botës, akademikë të njohur, si dhe përfaqësues të tregut të sigurimeve, të cilët diskutuan mbi mbikëqyrjen ndërkombëtare të sigurimeve duke u fokusuar në trendin global të mbikëqyrjes me bazë rreziku dhe sfidat që lidhen me zbatimin e standardeve globale.

### Zhvillohet programi i trajnimit “Train the Trainers” për aktuar

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Angli zhvilluan në datat 18-22 shtator 2017 një *workshop* për aktuarët e sapo certifikuar nga Shqipëria dhe Kosova. *Workshop*-i kishte në program edhe takime me përfaqësues të institucioneve kryesore të tregut të sigurimeve në Angli. Në këto takime u diskutuan çështje lidhur me punën e aktuarit, zhvillimet e tregut të sigurimeve, profesionit të aktuarit në Angli dhe lidhjet e mundshme me përvojën shqiptare.

Ndër çështjet e diskutuara gjatë këtij programi trajnimi, ishin:

- Nga pikëpamja e sigurimit të Jo-Jetës, metodologjia e përcaktimit të çmimeve dhe rezervave ishte me interes, siç ishin praktikat e përdorura për t'u përballur me dëmet në rritje;
- Nga pikëpamja e sigurimit të Jetës dhe shëndetit, ishte me interes

Profesioni i aktuarit në vend gjithashtu do të marrë një nxitje të menjëhershme si rezultat i drejtpërdrejtë i këtij programi, pasi disa nga hapat e sugjeruar nga Profesionin në Mbretërinë e Bashkuar mund të merren menjëherë.

mënyra se si tregu i Mbretërisë së Bashkuar po trajtohej me sigurime mjekësore dhe përvoja me mbulimin e grupeve;

- Nga pikëpamja mbikëqyrëse, diskutimi i sinjaleve kryesore paralajmëruese për përqendrimin e vëmendjes së zonave me rrezik të lartë;
- Nga pikëpamja e zhvillimit profesional diskutimi i kualifikimeve të lëshuara nga Profesionin (IFoA) në Mbretërinë e Bashkuar e sidomos për testet e zhvilluara online, iu prezantoi pjesëmarrësve një rrugë mjaft tërheqëse për kualifikime të njohura ndërkombëtare;
- Nga një këndvështrim organizativ, pasqyrimi i punës së kryer nga Profesionin në Angli dhe përvoja e shoqatave të tjera në tregje më pak të zhvilluara të sigurimeve, iu dha pjesëmarrësve një rrugë përpara drejt motivimit, që të çojnë Shoqatën e Aktuarëve të Shqipërisë në një tjetër stad.

Ndikimi kryesor i këtij programi pritet në disa drejtime:

Profesionalisht, një sërë teknikash të përdorura për llogaritjen e rezervave u diskutuan me shumë kompani për t'u përdorur në punën e përditshme aktuariale. Gjithashtu, disa koncepte të përcaktimit dhe llogaritjes së çmimeve dhe vlerësimit të nevojave për kapital mund të jenë me interes nëse ndonjëra nga shoqëritë në treg vendos të angazhohet, ndonëse fushëveprimi i ushtrimeve të tilla do të jetë shumë i reduktuar në krahasim me ato të prezantuara gjatë takimeve, për shkak të vetë zhvillimit të tregut shqiptar. Në përfundim, baza e të dhënave dhe burimet e vëna në dispozicion nga Profesionin në Mbretërinë e Bashkuar do të mundësojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional me kosto të ulët të këtyre aktuarëve, pasi teknika dhe çështje me interes do të jenë menjëherë në dispozicion.

Profesionin i aktuarit në vend gjithashtu do të marrë një nxitje të menjëhershme si rezultat i drejtpërdrejtë i këtij programi, pasi disa nga hapat e sugjeruar nga Profesionin në Mbretërinë e Bashkuar mund të merren menjëherë. Këto hapa përfshijnë aplikimin për statusin e plotë të anëtarësimit në Shoqatën Ndërkombëtare të Aktuarëve dhe krijimin e kontakteve formale me Profesionin në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjatë diskutimeve është propozuar që programi i ardhshëm afatgjatë për kualifikim profesional të përmbajë dhe të fillojë me kualifikimin ndërkombëtar CAA (asistent aktuar i njohur ndërkombëtar) dhe të vijojë për studentët e suksesshëm duke e përmbyllur me programin e IAA për t'u certifikuar si aktuar, më qëllim licencimin nga AMF. Kërkohej që të nisin biseda dypalëshe AMF-IFoA në mënyrë që Autoriteti të shërbejë si qendër rajonale për testimin dhe trajnimin e aktuarëve.

—○○○—  
Diskutimet prezantuan  
kuadrin aktual të  
zhvillimeve ekonomike, si  
edhe perspektivat e  
zhvillimeve të ardhme.  
—○○○—

## **Takimi i 9-të i Nënkomitetit për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, BE-Shqipëri**

Në datën 28 shtator 2017 u zhvillua në Bruksel takimi i Nënkomitetit të Stabilitetit Asociimit “Çështjet Ekonomike Financiare dhe Statistikat”, mbi raportimin e zhvillimeve ekonomike dhe financiare të Shqipërisë në kuadër të rekomandimeve të BE-së.

Në takim, nga përfaqësuesit e BE-së u vunë në dukje zhvillimet progresive të ekonomisë shqiptare, përmirësimi i klimës së biznesit, ecuria pozitive e reformave në fushën ekonomike dhe atë fiskale, stabiliteti makroekonomik, si dhe qëndrueshmëria e sistemit bankar dhe ulja e borxheve të këqija.

Në takimin e këtij viti, pala evropiane kishte caktuar si pikë të veçantë në axhendë për raportim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare çështjen e Bursës Shqiptare të titujve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadrin e këtij takimi, kishte hartuar raportin përkatës mbi zhvillimet e tregut të titujve në Shqipëri dhe licencimin e Bursës Shqiptare të titujve.

## Rregullimi i tregjeve financiare dhe mbikëqyrja e sigurimeve gjithëpërfshirëse

*Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) ka publikuar një dokument mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve gjithëpërfshirëse të sigurimeve, ku synohet gjetja e mjeteve për përfshirjen në skemat e sigurimeve të shtresave të marginalizuara dhe atyre me të ardhura nën mesataren. Dokumenti shërben si një udhërrëfyes në zbatimin e skemave gjithëpërfshirëse të sigurimeve.*

*(Marrë me shkurtime e redaktime – pjesa e dytë)*

Për kapërcimin e pengesave në lidhje me produktet e mikrosigurimit është e nevojshme që gjërat të bëhen ndryshe. Inovacioni mund të përfshijë ndryshime tek karakteristikat e produktit, shërbimet e ofruara, kanalet dhe mjetet për dërgimin e produkteve, shërbimeve dhe ofruesin e produktit (siguruesin). Në përgjithësi, kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit janë më të larta kur qasja në sigurime është në vend të parë. Mekanizmat mbrojtës duhet të përshtaten në një segment të klientëve me kulturë të ulët financiare, si edhe me pak ose aspak përvojë në sigurime. Ndërkohë që mbahet në nivele të ulëta kosto e transaksioneve, është e rëndësishme që të adresohet zbulimi efektiv, thjeshtësia e produkteve, zgjidhja e drejtë dhe e arritshme e mosmarrëveshjeve dhe mekanizmave efikase të dëmshpërblimit.

Gjithnjë e më shumë, mbikëqyrësit po lehtësojnë tregun e sigurimit "gjithëpërfshirës" që punon në mënyrë efektive për popullsinë me të ardhura të larta si dhe atë me të ardhura të ulëta.

Gjithnjë e më shumë, mbikëqyrësit po lehtësojnë tregun e sigurimit "gjithëpërfshirës" që punon në mënyrë efektive për popullsinë me të ardhura të larta si dhe atë me të ardhura të ulëta. Këto iniciativa kanë për qëllim zhvillimin e legjislacionit dhe praktikave mbikëqyrëse që inkurajojnë siguruesit ekzistues për t'i shërbyer popullsisë me të ardhura të ulëta ose që motivojnë ofruesit jo-formalë dhe ndërmjetësit për t'u integruar me sektorin formal të sigurimeve. Për ta bërë këtë, shpesh kërkohet koordinim dhe bashkëpunim ndërsektorial mes autoriteteve publike, duke përfshirë këtu bankat qendrore, autoritetet tatimore, rregullatorët e telekomunikacionit, autoritetet shëndetësore dhe departamentet e bujqësisë e mbrojtjes sociale.

### Produktet dhe shërbimet

Produktet e mikrosigurimit ofrojnë mbrojtje nga risku për popullsinë me të ardhura të ulëta ndaj rreziqeve të caktuara të Jetës ose Jo-Jetës, duke ofruar një shumëllojshmëri produktesh të realizuara sipas kërkesave që përfshijnë pronën, jetën, shëndetin, kredinë, bujqësinë dhe mbulimin e katastrofave. Produktet janë të projektuara dhe të kuotuar në proporcion me probabilitetin dhe koston e risqeve të përfshira. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë në një treg me performancë të dobët e konsiderojnë sigurimin një "shpenzim të humbur" dhe kanë një perceptim negativ. Këta faktorë kanë kufizuar përdorimin e sigurimeve në mesin e popullatave me të ardhura të ulëta. Si pasojë, jeta dhe asetet e tyre janë të ekspozuara ndaj risqeve të shumëfishta

dhe aftësia për të gjeneruar të ardhura dhe për të grumbulluar pasuri është dobësuar.

Kohët e fundit, siguruesit dhe ndërmjetësit e ndryshëm kanë filluar të projektojnë produkte inovative dhe modele shpërndarjeje që i përshtaten kërkesave të popullsisë me të ardhura të ulëta. Gjithashtu, në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të sigurohet që klientët të kuptojnë zgjedhjet që bëjnë, detyrat dhe të drejtat e tyre dhe të jenë në gjendje t'i ushtrojnë këto të drejta. Në lidhje me sigurimin më konvencional, tiparet themelore të produkteve të orientuara drejt përfshirjes së shtuar mund të përfshijnë:

- Primet relativisht të ulëta;
- Mbulimin e përcaktuar dhe të kufizuar;
- Termat e politikave afat-shkurtra për kufizimin e riskut;
- Disa prej tyre, nëse ka përjashtime;
- Preferenca për marrjen në sigurim të grupit;
- Përpunim i thjeshtë dhe i shpejtë i ankesave/kërkesave për dëmshpërblim.

Përvojat e fundit kanë dëshmuar se klientët mund ta përballojnë dhe do ta përdorin sigurimin nëse "ofrohet në mënyrën e duhur". Për shkak të ndryshimeve të mëdha në segmentet me performancë të dobët, nevojat dhe preferencat e mbrojtjes po ndryshojnë në bazë të faktorëve të tillë si profesioni, komuniteti, edukimi dhe vendndodhja. Për shembull, sigurimi i Jetës duhet të jetë çështje prioritare për çdo kryefamiljar, edhe pse bindjet kulturore mund ta pengojnë këtë. Mbrojtja e banesave, mjeteve të punës, dhe bagëtisë duhet të jetë prioritet për kategoritë e ekspozuara nga përmbytjet, ndërsa sigurimet e tjera mund të mbrojnë nga humbja e kulturave bujqësore për shkak të thatësisë në zonat rurale.

### **Kanalet për shpërndarjen**

Shpeshherë klientët potencialë jetojnë gjeografikisht larg vendit nga ku ofrohen shërbimet e sigurimit dhe mund të emigrojnë në kërkim të punës me periudha sezonale. Kjo e bën sfiduese shitjen dhe ofrimin e asistencës për këto produkte. Qasja në tregjet gjithëpërfshirëse të sigurimeve mund të rritet nga një gamë e larmishme e ndërmjetësve, duke përfshirë brokerat, bankat e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare, institucionet jo-qeveritare, marketingun e drejtëpërdrejtë (me callcenter), postën direkte, etj.

Shpërndarja gjithashtu mund të zgjerohet nëpërmjet skemave ose grupeve të fokusuara në komunitet, dhe shoqatat e kreditit (creditunions), si dhe shpërndarësit inovativë në masë të tillë si pikat e shitjes me pakicë, zyrat e postës, shoqatat fetare ose sindikatat. Jo vetëm që këto zyra alternative mund të kapërcejnë barrierat gjeografike, por ato gjithashtu mund të jenë efikase për uljen e mëtejshme të kostove, shfrytëzimin e infrastrukturës dhe tejkalimin e çështjeve të mosbesimit në lidhje me këto produkte.

Shpeshherë klientët potencialë jetojnë gjeografikisht larg vendit nga ku ofrohen shërbimet e sigurimit dhe mund të emigrojnë në kërkim të punës me periudha sezonale.



## Maqedoni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në fund të marsit 2017, tregu i sigurimeve në Maqedoni ka gjeneruar të ardhura prej 2.24 miliardë dinarë (monedha lokale MKD), ose rreth 36.37 milionë euro, me një rritje prej 4.68% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, primet e shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës janë rritur me 3.39%, ndërsa ato për sigurimin e Jetës kanë shënuar rritje me 14.88%.

## Itali

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Drejtimesit e makinave në Itali do të përfitojnë tarifa më të ulëta për sigurimin MTPL, nëse bien dakord që mjete i tyre t'i nënshtrohet një inspektimi paraprak nga kompania e sigurimit, të instalojnë kuti të zeza, ose një mekanizëm elektronik që nuk lejon ndezjen e motorit nëse konstatohet një normë mbi normalen e alkoolit në gjak. Uljet do të jenë më të mëdha për shoferët me një historik të pastër në aksidente gjatë katër viteve të fundit, që banojnë në provincat me numër të lartë aksidentesh, gjë që zakonisht deri tani i ka detyruar të paguajnë prime më të shtrenjta. Uljet do të aplikohen te policat e reja, por edhe tek ato ekzistueset.

## Greqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Shoqata greke e kompanive të sigurimit raporton të ardhura në vlerën 1.9 miliardë euro në gjysmën e parë të vitit 2017 nga ky treg, ose 1.2% më shumë se një vit më parë. Sektori i Jo-Jetës ka gjeneruar 51% të këtyre të ardhurave, ndërsa pjesën tjetër sektori i Jetës, që ka shënuar një rritje më të madhe.

## Rumani

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Rumani gjeneroi 2.56 miliardë RON (Lei rumun, monedha vendase) ose rreth 567 milionë euro të ardhura në fund të muajit mars 2017, me një rritje vjetore në masën 8.2%, sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Rumani, ASF. Totali i primeve të shkruara bruto përbëhet kryesisht nga produkti MTPL (rreth 43%), sigurimet Kasko (17%), sigurim prone (11.2%) dhe sigurim Jete (21%).

## Sllovaki

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në tremujorin e parë të vitit 2017, tregu i sigurimeve në Sllovaki gjeneroi një volum prej 569.5 milionë euro nga primet e shkruara bruto, me një rritje vjetore 4.6%, sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Sllovakisë. Vlera e dëmeve të paguara u rrit me 6.7% nga viti në vit, në masën 297 milionë euro. Sigurimet e Jetës (5.4% rritje, rreth 253.4 milionë euro) zënë 44.5% të totalit të primeve të shkruara bruto. Nga kjo shumë, rreth 127 milionë euro janë gjeneruar nga sigurimet e Jetës të lidhura me skema investimesh, ndërsa policat e tjera tradicionale kanë sjellë 54.1 milionë euro të ardhura. Primet e Jo-Jetës gjeneruan pjesën tjetër të të ardhurave, në masën 55.5%, nga të cilat 29.9% nga sigurimi motorik (MTPL 91.9% dhe Kasko 13.7%).



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al